

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

14 JIL / 3

VENDIM
I Gjyqtarit te Vetem

Une gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane Fajzine Dullaku sot me date 21/02/2000, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga drejtori i shoqerise anonime "Bojra Llake "Sha, Koco Kokedhima dhe

KONSTATOVA

Se me kerkesen drejtuar Gjykates, drejtori i shoqerise Koco Kokedhima kerkon depozitimin e vendimeve te Mbledhjes se Jashtezakonshme te Aksionereve si dhe miratimin nga ana e kesaj gjykate e ekspertit kontabel te autorizuar z. Ethem Sula i cili do te beje vleresimin e kapitalit te ndermarrjes per pasqyrimin e humbjeve per vitet 1997 dhe 1998, dhe te investimeve te kryera nga aksioneri Koco KOKEDHIMA, mbeshtetur ne ligjin nr. 7938 date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare",

Rezulton se Ethem Sulaj me profesionin ekonomist financier ben pjese ne listat e eksperteve kontabel te autorizuar per vleresimin e kapitalit te shoqerive tregtare te miniratuara nga Ministri i Financave.

Ne kushte te tilla mbeshtetur ne ligjin nr. 7638 date 19.11. 1992 "Per shoqerite Tregtare" nenet 65, 84, 168 dhe 169 te ligjit nr. 7667 dt. 28.01.1993 dhe ligjit nr. 7926 date 20.04.1995 si dhe ne baze te deklarates perkatese te bere perpara gjykates nga Ethem Sulaj, cmoj se kerkesa e paraqitur eshte e bazuar dhe si e tille duhet te pranohet.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit nr. 7667 dt. 28.01.1993 dhe ligjit nr. 7938 date 19.11.1992 ;

VENDOSA

- Depozitimin e vendimeve nr. 1 dhe 2. Te Mbledhjes se Jashtezakonshme te Aksionereve
- Miratimin si ekspert kontabel te autorizuar z. Ethem Sulaj per pasqyrimin e ndryshimeve te kapitalit te shoqerise "Bojra Llake"ShA, Tirane.

Tirane date 21/02/2000.

GJYQTARE

Fajzine Dullaku
F. Dullaku

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr 1421/2000 Akt

VENDIM
I Gjyqtarit te Vetem

Une gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane Mariana Dedi sot me date 11/05/2000, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga drejtori i shoqerise anonime "Bojra Llake"sha, Koco Kokedhima dhe

KONSTATOVA

Se me kerkesen drejtuar Gjykates, drejtori i shoqerise Koco Kokedhima kerkon depozitim e vendimeve te Mbledhjes se Jashtezakonshme te Aksionereve.

Sipas dokumentacionit te paraqitur rezulton se:

Me vendimin nr.1 date 27/4/2000 mbledhja e jashtezakonshme e shoqerise ka vendosur te zmadhoje kapitalin e saj themeltar, ne natyre. Sipas raportit te vleresimit te ekspertit kontabel kapitali themeltar i shoqerise pas zmadhimit behet 121,392,918. Leke.

Pas zmadhimit te kapitalit ndryshon raporti i zoterimit te aksioneve ku z. Koco Kokedhima zoteron 90,921% te aksioneve ose 110,371.655 aksione dhe Ministria e Ekonomise Publike dhe Privatizimit zoteron 9,079% te aksione ose 11,021.261 aksione gjithsej

Me vendimin nr.3 Mbledhja e Jashtezakonshme e shoqerise ka vendosur Ndryshimin e emrit te shoqerise me emrin e ri "Boja Tirana"sha.

Ne keto kushte mbeshtetur ne ligjin nr. 7638 date 19.11. 1992 "Per shoqerite Tregtare" te ligjit nr. 7667 dt. 28.01.1993 dhe ligjit nr. 7926 date 20.04.1995, cmoj se kerkesa e paraqitur eshte e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet te pranohet.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit nr. 7667 dt. 28.01.1993 dhe ligjit nr. 7938 date 19.11.1992 ;

VENDOSA

Depozitim e vendimeve nr. 2 dhe nr.3 te Asmablse se Jashtezakonshme te aksionereve.

- Kapitali themeltar i shoqerise pas zmadhimit eshte 121,392,918. Leke .
- Aksioneri Koco Kokedhima zoteron 90,921% te aksioneve gjithsej ose 110,371.655 aksione
- Ministria e Ekonomise Publike dhe Privatizimit zoteron 9.079% te aksione gjithsej ose 11,021.261 aksione.

Depozitim e vendimit nr.2 te Asamblese se Jashtezakonshme te aksionereve.